Duke u njohur me Kullat e Sahatit në Shqipëri



ANDI PAPASTEFANI, ARKITEKT

Në ka një tipologji ndërtimore sa të çuditëshme aq dhe të veçantë, këto janë kullat e sahatit. Të larta dhe arrogante në dukje, por sociale në gjithë esencën e tyre. Jo më të nevojshme në ditët tona, por të dashura nga banorët dhe identifikuese të siluetave dhe qendrave të qyteteve. Pothuajse të pavdekshme si ulliri që edhe kur kalon mijëvjecarin vazhdon të jetojë, kullat e sahateve vazhdojnë të nderohen sado rrallë edhe gjatë shek. XXI. Ato janë dashuria dhe ankthi i inxhinierëve të strukturave që i studiojnë në detaj dhe i përforcojnë për t'i mbajtur në këmbë për të mirën e njerëzimit dhe historisë, duke iu rezistuar tërmeteve, vjetërsisë ndërtimore dhe mendjelehtësisë njerëzore.

Origjina e kullave të sahatit është në Europë rreth shek. XI. Të ndërtuara për të treguar dhe menaxhuar kohën për populsinë, ato shërbenin gjithashtu për lajmërime të rëndësishme. Në pjesët e Turqisë evropiane ku bënte pjesë edhe vendi ynë, kullat e sahatit filluan të ndërtohen në shek. XVI.

Studiuesi dhe arkeologu Dritan Çoku në monografinë e tij "Kullat e Sahatit në Shqipëri - Historia dhe Arkitektura", na jep për herë të parë një panoramë të plotë të kësaj tipologjie në vendin tonë. Ai na drejton në një itinerar unik në Shqipëri në kohë dhe në hapësirë nga kullat e sahateve në kalatë tona deri tek ato në qendër të qyteteve deri në shek. XX. Puna e tij në hartimin e këtij libri është si gishtat e dorës, pesëfishe, e rrallë për një studiues të vetëm. Së pari, ai ka vizituar dhe ka identifikuar vendodhjen e tyre në Shqipëri duke rreshtuar njëzet e një të tilla. Së dyti, Dritani i ka rilevuar, studiuar dhe vizatuar teknikisht



ato, duke prodhuar materialin grafik aq të nevojshëm atje ku ishte e mundur. Në këtë proces janë gërshetuar aftësitë e tij si një vizatues i aftë me rigorozitetin e studiuesit. Së treti, ai ka punuar seriozisht me materialin studimor për kullat e sahatit: hartat e moçme, vizatimet, fotot e vjetra, përshkrimet e udhëtarëve dhe dokumentet historike. Si rezultat i analizave dhe dialogut me këto burime, Dritani ka hartuar kronologjinë e secilës kullë sahati në vendin tonë. Ai ka ngritur hipoteza, ka saktësuar të dhëna dhe ka dhënë hollësi interesante. Së katërti, Dritani ka arritur t'i klasifikojë rigorozisht shembujt e këtyre kullave, duke na e bërë më të lehtë njohjen e tyre. Së fundi, ai ka mundur të na japë një libër të formuluar bukur, sa shkencor dhe të këndshëm. Falenderojmë këtu dhe botuesin, ALSAR, për botimin e fisshëm.

Në kohën kur u ndërtuan dhe për një kohë të gjatë pas kësaj kullat e sahatit në Shqipëri ishin nga pikat më të spikatura të siluetave të qyteteve. Kjo karakteristikë duhet të merret parasysh në planet tona urbanistike, duke mos i lënë këto objekte të veçanta në hije, siç është rasti i kullës së sahatit në Tiranë. Libri na bën të ndërgjegjshëm se sa seriozitet dhe punë na duhet ne si vend për t'i mbajtur të gjalla këto ndërtime unike.

Ky libër të motivon, të shtyn ta rivizitosh vendin tonë, të shkosh në qytete të vogla si Kavaja dhe Peqini për të admiruar punën e mjeshtrave tanë dhe organizimin e komuniteteve. Të bën kurioz të endesh në labirinthet e historisë për ta plotësuar (nëse ke mundësi) sadopak këtë tablo. Të emocionon dhe të dhemb kur kupton se p.sh., kulla e sahatit të Durrësit dhe ajo e Nartës na kanë humbur përgjithmonë.

Duke admiruar kullën e sahatit në stilin art Deco të Vlorës, duke u njohur me kullat e sahatit të ndërtuara në vitet '60 - '70 të shek. XX, lexuesi kupton se kjo tipologji ndërtimore nuk do të ezaurohet, por do të vazhdojë edhe në shekujt e ardhëshëm.

Ky libër do ngelet gjithmonë aktual dhe burim të dhënash shkencore në duart e arkitektëve, inxhinierëve të ndërtimit, studentëve e koleksionistëve. Është një gur mozaiku në tablonë botërore të kësaj tipologjie, kontribut i aftësive ndërtuese të popullit tonë.

Sugjeroj një adaptim të këtij materiali për turistët e shumtë që vizitojnë qytetet tona dhe një variant të këtij libri në gjuhën angleze.

Duke rishfletuar këtë botim të këndshëm, i uroj Dritan Çokut shëndet dhe suksese dhe gjithashtu uroj që të na surprizojë në vazhdim me punime të tilla të cilësisë së lartë.

Cyan Magenta Yellow Black